



# **RAPORT MONITORIMI MBI PROCEDURËN E HEDHJES SË SHORTIT PËR KRIJIMIN E KËSHILLIT TË PËRKOHSHËM TË EMËRIMEVE NË SISTEMIN E DREJTËSISË**

---

Për më shumë informacione lidhur me veprimtarinë e institucionit të Avokatit të Popullit mbi Reformën në Drejtësi,  
lutemi kontaktoni:

**Institucioni i Avokatit të Popullit**

**Blvd: “Zhan D’Ark” Nr. 2, Tiranë, Shqipëri,**

**Tel./Fax: +355 (4) 2380 300/ +355 (4) 2380 315**

**Web: [www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)**

Reforma në Drejtësi si një prej pesë prioriteteve kryesore për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian, ka marrë fokus të vecantë në punën e institucionit të Avokatit të Popullit, jo vetëm për shkak të detyrimeve ligjore në përcaktuara në legjislacionin përkatës, por edhe për shkak të vetë rëndësisë që ka kjo reform dhe që lidhet drejtëpërdrejtë me respektin e të drejtave të njeriut në vendin tonë.

Sikundër parashikohet në nenin 284 të ligjit nr. 115/2016, “*Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë*”, pika 6 citohet roli i institucionit të Avokatit të Popullit në këtë proces dhe konkretisht citohet se:

“Presidenti i Republikës organizon shortin për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Përkohshëm të Emërimeve në Drejtësi pa vonesë. Procedurat e shortit dokumentohen nga Presidenti i Republikës. **Procedurat e shortit zhvillohen në prani të Avokatit të Popullit, i cili harton dhe bën publik një raport monitorimi mbi procedurën e shortit.**

Si dhe në pikën 8 citohet se: “Presidenti i Republikës boton një relacion për procesin e zgjedhjes në faqen zyrtare të Presidencës. **Avokati i Popullit publikon raportin monitorues në faqen zyrtare të tij**”

Në vijim të këtij detyrimi ligjor, institucioni i Avokatit të Popullit në datë 12.01.2017, me shkresën nr. 01/1 prot; ka kërkuar një informacion paraprak nga institucioni i Presidentit të Republikës mbi procedurat nëse ekzistonte ndonjë udhëzim përkatës, mbi procedurat e hedhjes së shortit për këtë proces.

Në vijim të kërkesës tonë, me shkresën nr. 03/1 prot datë 12/01/2017 nga institucioni i Presidentit jemi vënë në dijeni se: ***Referuar nenit 288 të ligjit 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, gjykojmë se informacioni paraprak i kërkuar mbi procedurat apo ndonjë udhëzim mbi këto procese mund të merret nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.***

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, me shkresën nr. 294 prot datë 24.01.2017, ky i fundit ka nxjerrë vendimin nr. 3 datë 24.01.2017 “*Për përcaktimin e procedurës dhe rregullave të hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi*”, vendim i cili i është përcjelle edhe institucionit të Avokatit të Popullit me shkresën nr. 297 prot datë 24.01.2017.

Në njoftimin përkatës, bazuar në pikën 3 të nenit 149/d të Kushtetutës si dhe nenet 221 dhe 284 të ligjit nr. 115/2016 “*Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë*”, shorti është përcaktuar të zhvillohet në datë 27.01.2017 në orën 10:00 në ambientet e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Të ftuar për të ndjekur këtë procedurë, ishin përfaqësues nga Gjykata Kushtetuese; Gjykata e Lartë; Prokuroria e Përgjithshme; Avokati i Popullit; Përfaqësues të grupeve parlamentare; Përfaqësi të huaja diplomatike të akredituara në Republikën e Shqipërisë dhe të organizatave partnere ndërkombëtare në cilësinë e vëzhguesve si dhe media. **U**

## **konstatua se kishte mungesë të përfaqësuesve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë; të Gjykatave të Apelit si dhe Gjykatave Administrative.**

Për hedhjen e shortit ishte krijuar një Sekretari Teknike i caktuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit.

Për këtë procedurë ishin të vendosura dy kuti transparente, ku në njërin prej kutive ishin të vendosura vendosura goglat dhe ndërkohë në kutinë tjetër (e cila fillisht ishte bosh), u vendosen goglat në të cilat ishin futur shiritat e letrës të shënuara me emrat e kandidatëve të propozuar nga secili institucion sipas listës të përcjellë Kuvendit të Shqipërisë dhe të publikuara në faqen e Kuvendit.

Shiritat e letrës më emrat e kandidatëve pasi u lexuan publikisht edhe në praninë e mediave u futen në gogla dhe rradha e hedhjes së shortit u përcaktua duke u mbështetur në renditjen e mëposhtme:

- Kandidatë nga Gjykata Kushtetuese
- Kandidatë nga Gjykata e Lartë;
- Kandidatë nga Prokuroria e Përgjithshme;
- Kandidatë nga Gjykata e Apelit;
- Kandidatë nga zyrat e prokurorisë pranë gjykatave të apelit;
- Kandidatë nga gjykatat administrative.

Përfaqësuesit e institucioneve përkatës nga neni 284 i ligjit nr.115/2016 "*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*", u tërhoqen sipas rradhës së mësipërme nga kutia përkatëse.

- 1- Lidhur me procedurën për përzgjedhjen e kandidatëve nga Gjykata Kushtetuese (8 kandidatë sipas listës përkatëse), përfaqësuesi i Gjykatës Kushtetuese pasi bëri përzierjen e goglave, në mënyrë rastësore tërhoqi emrat e dy kandidatëve dhe i lexon me zë të lartë duke ja vënë në dukje Sekretariatit Teknik dhe të gjithë përfaqësuesve pjesëmarrës emrat.

Konkretisht, nga Gjykata Kushtetuese u përzgjodhën gjyqtarët: Besnik Imeraj dhe Vladimir Kristo.

Shiritat e letrës që gjendeshin brenda goglave të përzgjedhura, ju dorëzuan Sekretariatit Teknik. Kandidaturat e mësipërme do të jenë anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Me të njëjtin short dhe të njëjtën procedurë, u zgjidh edhe një anëtar zëvendësues nga Gjykata Kushtetuese sipas parashikimeve të pikës 7, të nenit 221 të ligjit nr.115/2016

*“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*, dhe konkretisht gjyqtarja Altina Xhoxhaj.

Pas tërheqjes së goglave nga përfaqësuesi i Gjykatës Kushtetuese, kutia transparente u zbraz dhe në të u futen goglat me emrat e kandidatëve të dërguar nga Gjykata e Lartë sipas rradhës së caktuar në këtë vendim.

- 2- Lidhur me procedurën për përzgjedhjen e kandidatëve nga Gjykata e Lartë (13 kandidatë sipas listës përkatëse), përfaqësuesi i Gjykatës së Lartë pasi bëri përzierjen e goglave, në mënyrë rastësore tërhoqi emrin e një kandidati dhe i lexon me zë të lartë duke ja vënë në dukje Sekretariatit Teknik dhe të gjithë përfaqësuesve pjesëmarrës emrat.

Konkretisht, nga Gjykata e Lartë u përzgjedh gjyqtarja: Mirela Fana.

Shiriti i letrës që gjendej brenda goglës së përzgjedhur, ju dorëzuan Sekretariatit Teknik. Kandidati, i mësipërme do të jetë anëtar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Me të njëjtin short dhe të njëjtën procedurë, u zgjidh edhe një anëtar zëvendësues nga Gjykata e Lartë sipas parashikimeve të pikës 7, të nenit 221 të ligjit nr.115/2016, *“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”*, dhe konkretisht gjyqtari Artan Zeneli.

- 3- Procedurat për përzgjedhjen e kandidatëve nga Prokuroria e Përgjithshme nuk u zhvilluan për shkak se nga Prokuroria e Përgjithshme ishte dërguar vetëm një emër, i cili *“ipso-jure”* u konsideruar anëtar i këtij këshilli pa nevojën për hedhjen e shortit përkatës. Konkretisht, u caktua emri i prokurores Rovena Gashi.

Lidhur me procedurën për përzgjedhjen e kandidatëve zëvendësues, procedura nuk u zhvillua për shkak se nuk ishte përcjellë asnjë emër për pozicionet përkatëse.

- 4- Procedurat për përzgjedhjen e kandidatëve nga Prokuroria panë Gjykatave të Apelit nuk u zhvilluan për shkak se nga ky institucion ishte dërguar vetëm dy emër, aq sa është edhe numri i vendeve për këtë këshill, të cilët *“ipso-jure”* u konsideruan anëtar i këtij këshilli pa nevojën për hedhjen e shortit përkatës. Konkretisht, u caktuan emrat e prokurorëve Gentian Trenova dhe Fatjona Memçaj.

Lidhur me procedurën për përzgjedhjen e kandidatëve zëvendësues, procedura nuk u zhvillua për shkak se nuk ishte përcjellë asnjë emër për pozicionet përkatëse.

- 5- Lidhur me procedurën për përzgjedhjen e anëtarëve nga Gjykatat e Apelit, në mungesë të një përfaqësuesi të pranishëm në këtë short, tërheqja e goglave u krye nga Avokati i Popullit, z. Igli Totozani.

Pasi u bë përzierja e goglave, në mënyrë rastësore u tërhoqën emrat e dy kandidatëve të cilat u lexuan me zë të lartë duke ja vënë në dukje Sekretariatit Teknik dhe të gjithë përfaqësuesve pjesëmarrës emrat.

Konkretisht, nga Gjykatat e Apelit u përzgjedhën gjyqtarët: Brikena Peraj (Lubonja) dhe si Ervin Metalla.

Shiriti i letrës që gjendej brenda gogllës së përzgjedhur, ju dorëzuan Sekretariatit Teknik. Kandidatët, e mësipërm do të jetë anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

- 6- Lidhur me procedurën për përzgjedhjen e anëtarëve nga Gjykatat Administrative (13 kandidatë), në mungesë të një përfaqësuesi të pranishëm në këtë short, tërheqja e goglave u krye nga përfaqësuesi i Gjykatës së Lartë.

Pasi u bë përzjerja e goglave, në mënyrë rastësore u tërhoq emri I një kandidati, i cili u lexua me zë të lartë duke ja vënë në dukje Sekretariatit Teknik dhe të gjithë përfaqësuesve pjesëmarrës emrat.

Konkretisht, nga Gjykatat e Administrative u përzgjedh gjyqtari Kastriot Selita.

Shiriti i letrës që gjendej brenda gogllës së përzgjedhur, ju dorëzuan Sekretariatit Teknik. Kandidati, e mësipërm do të jetë anëtarë të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.

Me të njëjtin short dhe të njëjtën procedurë, u zgjidh edhe një anëtar zëvendësues nga Gjykatat e Apelit dhe ato Administrative sipas parashikimeve të pikës 7, të nenit 221 të ligjit nr.115/2016, "*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*", dhe konkretisht gjyqtari Gentian Meja.

Në përfundim të këtij procesi, u përzgjedhën në total 9 anëtarë për të qënë pjesë e Këshillit të Përkohshëm të Emërimeve në Sistemin e Drejtësisë si dhe rezultatet e shortit dhe procedurat e hedhjes së shortit u regjistruan në audio dhe video përkatëse.